REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 181/1 Prot. Tiranë, më 16.02.2023

**VENDIM**

**Nr. 9, datë 16/02/2023**

**MBI**

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË TRAJNIMIT DHE SHPËRBLIMIT TË TRAJNUESVE PËR MODULIN "MËSIMDHËNIA E MUZIKËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI NDRYSHE"**

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për "*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", të Udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021 "*Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*", të Statutit të UART dhe shkresës nr. 102 prot., datë 08.02.2023 me lëndë "Për fillimin e trajnimeve në Fakultetin e Muzikës dhe Njësisë bazë KMDP sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit", pasi e shqyrtoi,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e tarifës së trajnimit për modulin "Mësimdhënia e muzikës për nxënësit me aftësi ndryshe", sipas propozimit të Njësisë Bazë KMDP bashkëngjitur.

2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

**Lavdrim SAHITAJ**

______________

**(Kryetar)**

**Prof. Besnik Bisha**

______________

**(Anëtar)**

**Jeton SHEHU**

______________

**(Anëtar)**

**Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI**

______________

**(Anëtar)**

**Ergis SEFA**

______________

**(Anëtar)**

**Lorenc VANGJELI**

______________

**(Anëtar)**

**Vladimir LLAKAJ**

______________

**(Anëtar)**

UNIVERSITETI I ARTEVE - REPUBLIKA E SHQIPËRISË - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**REKTORATI**
**ZËVENDËS REKTOR**

Nr. 181 prot. Tiranë, më 13.02.2023

Lënda: *Dërgohet për shqyrtim në Bordin e Administrimit propozimi i Njësisë Bazë KMDP për tarifën e trajnimit për modulin "Mësimdhënia e muzikës për nxënësit me aftësi ndryshe"*

**Lavdrim SAHITAJ**

**KRYETAR**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**
**UNIVERSITETI I ARTEVE**

**Alma SINANAJ**

**ADMINISTRATORIT**
**UNIVERSITETI I ARTEVE**

Nëpërmjet kësaj shkrese po Ju përcjell bashkëlidhur për shqyrtim në Bordin e Administrimit propozimin e Njësisë bazë KMDP, pranë Fakultetit të Muzikës, për fillimin e trajnimeve sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të programeve/Moduleve të Trajnimit, me Nr. 102/1 Prot., datë 08.02.2023 me lëndë "Për fillimin e trajnimeve në Fakultetin e Muzikës dhe Njësisë bazë KMDP sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit" dhe me Nr. 168 Prot., datë 09.02.2023 të UART. (praktika bashkangjitur).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**ZËVENDËS REKTOR**

**Prof.Dr. Erald Bakalli**

Nr. 168 Prot
09/02/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I MUZIKËS**
**DEKANATI**

**Nr. Prot.** 102/1 **Tiranë, më** 08.02**. 2023**

Lënda: Për fillimin e trajnimeve në Fakultetin e Muzikës dhe Njësisë Bazë KMDP sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit

**Zv.Rektor**

**Universiteti i Arteve**

**Sheshi Nënë Tereza**

**I nderuar zoti Bakalli,**

Bashkëngjitur do te gjeni propozimin e Njësisë Bazë KMDP, për fillimin e trajnimeve në Fakultetin e Muzikës dhe Njësisë Bazë KMDP sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit.

**DEKANI**

**Prof. Dr. Isak Shehu**

**FAKULTETI I MUZIKËS**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI I ARTEVE – FAKULTETI I MUZIKËS – TIRANË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
NJËSIA BAZË KMDP

Nr. 102 prot.

Tiranë, më 08.02.2023

**Lënda:** Për fillimin e trajnimeve në Fakultetin e Muzikës dhe Njësinë Bazë KMDP sipas vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit

**Dekanit të Fakultetit të Muzikës**
**Universiteti i Arteve**
**Sheshi Nënë Tereza**

Në vijim të proçedurave për çeljen e trajnimeve në fushën e mësuesisë, bazuar në Vendimin Nr. 18, datë 20.05.2022 të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit, bërë me dije nëpërmjet shkresë Nr. 555/17. prot, datë 30.05.2022, me tonën Nr. 1083.prot, datë 03.06.2022, Njësia Bazë KMDP ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për hapjen e trajnimit të sipërpërmendur, bazuar në propozimet e vetë njësisë.
Lidhur me sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,* Neni. 3, pika 3a, Neni 64 pika 2, Neni 84 pika 1,2,3, Neni 108 pika 3, në *Statutin e Universitetit të Arteve*, Neni 4 gërma i, Neni 6 pika 2 gërma a, pika 3 gërma a, Neni 12 pika 1, Neni 13 pika 3, Neni 44, Neni 85, sikurse dhe në *Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore në Fakultetin e Muzikës* Neni 29, dhe në parashikimet e Projekt-Buxhetit të Njësisë Bazë KMDP 2022-2024, dërguar me shkresën Nr. 942.prot, datë 21.07.2021, me tonën Nr. 80/1. datë 19.07.2021, propozojmë si më poshtë vijon:

- Trajnimi për modulin "Mësimdhënia e Muzikës për Nxënësit me Aftësi Ndryshe" me kodin 22GJ135, do të zhvillohet pranë Njësisë Bazë KMDP në Fakultetin e Muzikës dhe i adresohet të gjithë mësuesve të muzikës në Republikën e Shqipërisë.
- Orët e trajnimit, trajnuesit dhe kreditet e fituara do të administrohen në përputhje me Vendimin Nr. 18, datë 20.05.2022 të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit.
- Tarifa e trajnimit për çdo kandidat do të jetë në shumën **1500 ALL.**
- Propozojmë që shpërblimi i trajnueseve të jetë në masën 60% të tarifës së trajnimit.

**Prof. Asoc. Dorian Çene**

**Përgjegjës i Njësisë Bazë KMDP**

Nr. 1083 Prot
03/6/2022

Për firmim dhe evadim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Nr. 555/17 Prot. Datë 30 .05.2022

Lënda: Njoftim

UNIVERSITETI I ARTEVE, FAKULTETI I MUZIKËS

Bazuar në urdhrin nr. 461, datë 23.11.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për ngritjen e Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit", pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në aplikimin për akreditimin e programeve/ moduleve të trajnimit, gjeni bashkëlidhur Vendimin Nr. 18, datë 20 .05.2022, të Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit.

Duke ju falënderuar,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Gerti JANAQI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE/ MODULEVE TË TRAJNIMIT

Nr.217 prot. Tiranë, më 20 .05. 2022

VENDIM

Nr.118, Datë 20 .05.2022

## PËR AKREDITIMIN E MODULEVE TË TRAJNIMIT PËR AGJENCINË TRAJNUESE UNIVERSITETI I ARTEVE, FAKULTETI I MUZIKËS

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 23, të udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", urdhrit nr. 461, datë 23.11.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për ngritjen e Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit" dhe vendimit të Komisionit të Akreditimit të Programeve/ Moduleve të Trajnimit me nr. 101, datë 20.05.2022 , "Për akreditimin e moduleve të trajnimit",

## KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE/ MODULEVE TË TRAJNIMIT VENDOSI:

1. Të akreditohen modulet e trajnimit të paraqitura për akreditim nga agjencia trajnuese **UNIVERSITETI I ARTEVE, FAKULTETI I MUZIKËS**, pasi rezulton se përmbajtja e moduleve përmbush kërkesat e përcaktuara në udhëzimin nr. 16, datë 28.07.2021, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".

2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Bazuar në pikën 4, të nenit 23 të udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021, "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", afati i vlefshmërisë së akreditimit të moduleve është 20.05.2022 – 20.05.2026.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, për njoftimin e agjencive trajnuese fituese sekretariati i KAPT-it dhe agjencia trajnuese.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE / MODULEVE TË TRAJNIMIT**

Znj. Zamira Gjini, Kryetar

Z. Alqi Kushi, Anëtar

Z. Erzen Tola, Anëtar

Z. Gerti Janaqi, Anëtar

Znj. Dorina Rapti, Anëtar

Znj. Albana Çelaj, Anëtar

Znj. Ines Todhe, Anëtar

UNIVERSITETI I ARTEVE (FAKULTETI I MUZIKËS)

VLEFSHMËRIA E AKREDITIMIT ËSHTË: 20.05.2022 – 20.05.2026

| KODI PËR MODUL | TEMAT E MODULEVE QE KALOJNE | NR. I ORËVE TË MODULIT | NR. I KREDITEVE TË MODULIT | EMRAT E TRAJNERËVE | LLOJI I TRAJNIMIT |
|---|---|---|---|---|---|
| 22GJ135 | MËSIMDHËNIA E MUZIKËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI NDRYSHE | 18 | 1 | ELIONA LICI; DORIAN ÇENE | TRAJNIM I DREJTPËRDREJT |